



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 247/2 prot.

Tiranë, më 27.02.2025

VENDIM
Nr.4, datë 27.02.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR.1, DATË 11.02.2025

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr.1, datë 11.02.2025, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprime administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”,

KONSTATOVA SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar informacioni me shkresën nr. 989 prot., datë 26.12.2024, paraqitur nga nëpunësja Dorina Pjetri, me detyrë “Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, përmes të cilit ngrihen pretendime nga ana e nëpunëses, për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të saj.

Pas verifikimit të informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 1, datë 11.02.2025, “Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprime administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”, të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.1, datë 11.02.2025, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucion paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga titullari i institucionit, Prefekti i Qarkut të Lezhës, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 78, datë 05.12.2024, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” ndaj nëpunëses Dorina Pjetri, si dhe të rregullojë pasojat duke hequr aktin e masës disiplinore nga dosja e personelit të nëpunëses, si dhe nga Regjistri Qendror i Personelit (HRMIS).

Konstatoj se, brenda afatit të lënë në vendimin objekt i këtij verifikimi, me shkresën nr. 152/2 prot., datë 21.05.2025, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 247 prot., datë 24.02.2025, institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë ka informuar këtë të fundit në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Konkretisht, vërej se, me urdhrin nr. 28, datë 20.02.2025 (nr. 152/1 prot.), të Prefektit të Qarkut Lezhë, është konstatuar pavlefshmëria absolute e urdhrin nr. 78, datë 05.12.2024, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” nëpunëses Dorina Pjetri.

Njëkohësisht, në përmbajtjen e dispozitivit të vendimit paralajmërues, është urdhëruar njësia përgjegjëse të rregullojë pasojat duke hequr aktin e masës disiplinore “Vërejtje” nga dosja e personelit të nëpunëses Dorina Pjetri, si dhe nga Regjistri Qendror i Personelit, HRMIS.

Për sa u përshtrua më sipër, çmoj se nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë janë zbatuar detyrat e lëna në Vendimin Paralajmërues nr.1, datë 11.02.2025, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.1, datë 11.02.2025, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, në lidhje me veprime administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar”*.
2. Konstatimin e rregullimit të situatës së ligjshmërisë nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, në përputhje me detyrimet e Vendimit nr.1, datë 11.02.2025, të Komisionerit.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut të Lezhës dhe nëpunësja Dorina Pjetri.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha